



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

**Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Trashëgimisë Kulturore**

**(i) Misioni**

Siguron identifikimin dhe hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe projekteve në fushat e arsimit parauniversitar, rinisë, sportit duke synuar arritjen e standarteve bashkohorë në përputhje me politikat kombëtare dhe rajonale.

Siguron intensifikimin e jetës artistike kulturore për të gjitha grupmoshat e Bashkisë Peqin me qëllim; përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët; krijimin e mundësive çdo artisti të ri të rritet profesionalisht dhe të vlerësojë kontributin e çmuar të artistëve të njohur brenda dhe jashtë vendit.

**Sektori Standarteve Arsimore**

**(i) Misioni**

Siguron hartimin e politikave dhe strategjive të arsimit parauniversitar me qëllim ofrimin e këtyre shërbimeve me një infrastrukturë të standardeve bashkohorë kombëtare, për një brez të ri të shëndetshëm, të arsimuar dhe me ndjenjën qytetare;

**(ii) Detyrat**

- a. Harton projekte për të siguruar rritje të hapësirave mësimore në kopshte, shkollat 9-vjeçare dhe shkolla të mesme me qëllim rritje të kushteve të mësimdhënies e nxënies bashkëkohore;
- b. harton strategji për të mundësuar rritje të frekuentimit të shkollës nga fëmijët 5-6 vjeçarë;
- c. aplikon standarde të reja të infrastrukturës shkollore si: klasa me jo më shumë se 30-32 nxënës, ku përfshihet edhe krijimi i lehtësirave për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- d. harton politika dhe projekte për lehtësimin e kushteve për të gjithë fëmijët që jetojnë në kushte sociale të dobëta të qytetit nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së nevojshme për të plotësuar kërkesat ekzistuese dhe për të parashikuar kërkesat e ardhshme për ndërtime të reja për një nivel tjetër moshash;
- e. harton politika për të nxitur rritjen e kapaciteteve të brezit të ri;
- f. identifikon dhe aplikon programe mbështetëse edukative për fëmijët me probleme sociale;
- g. kryen mbledhjen dhe analizimin informacionit, me qëllim evidentimin e problematikave të infrastrukturës arsimore në objektet publike në bashki;
- h. evidenton gjendjen e godinave të sistemit arsimor që ka në varesi dhe merr masa për funksionimin normal të tyre.
- i. evidenton dhe merr masa për mirëmbajtjen e objekteve arsimore, si ngrohje, lysterje riparime, furnizim me energji, ujë, shërbim telefonik. Perlllogarit nevojat për investime a shërbime dhe ia paraqet Keshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim.
- j. merr masa për furnizimin e shkollave, kopeshteve dhe cerdheve me lëndë djegëse
- k. në baze të planit për bursat të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe zyra arsimore Peqin, merr masa për publikimin dhe evidentimin e kërkesave të qytetarëve për keto bursa. Pas evidentimit të kërkesave dhe verifikimit të tyre sipas kriterëve ligjorë përgatit materialin përkatës dhe ia paraqet Keshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim